

UDHËZIM
Nr. 14, datë 25.6.2025

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 22, DATË 10.7.2013, “MBI ZBATIMIN
E VENDIMIT NR. 870, DATË 14.12.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ‘PËR
TRAJTIMIN FINANCIAR TË PUNONJËSVE QË DËRGOHEN ME SHËRBIM
JASHTË VENDIT”**

Në zbatim të vendimit nr. 870, datë 14.12.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, pika 15 e tij, ministri i Financave

UDHËZON:

1. Në udhëzimin nr. 22, datë 10.7.2013, “Mbi zbatimin e vendimit nr. 870, datë 14.12.2011, të Këshillit të Ministrave, ‘Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit’”, fjali e dytë, e pikës 1 të udhëzimit, ndryshon si vijon:

“Punonjës të njësisë së qeverisjes së përgjithshme në kuptim të këtij udhëzimi, konsiderohen punonjësit organikë dhe punonjësit me kontratë të përkohshme pune të njësisë”.

2. Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
Petrit Malaj